



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 SHKURT 2024**

**SA SVEÇANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. FEBRUARA 2024. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Dnevni red

1. Obležavanje 16-godišnjice proglašenja nezavisnosti Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

E nderuara Presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu,

I nderuari President i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj,

I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

I nderuar president Sejdiu,

Kryetare Caka,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe nënkryetarë të Kuvendit,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier,

I nderuar përfaqësues i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Suniog,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,

Të nderuar drejtues të institucioneve tona shtetërore,

Të nderuara zonja dhe zotërinj të pranishëm,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju dëshiroj mirëseardhje në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e kremtimit të 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Shteti ynë sot i mbushi 16 vjet. Gëzuar të gjithëve! Urime!

Me këtë rast, para se ta fillojmë seancën, po ju ftoj që ta nderojmë himnin shtetëror të Republikës së Kosovës.

(Intonimi i himnit shtetëror të Kosovës)

Të nderuar të pranishëm, së pari e ftojme presidenten e Republikës së Kosovës, Shkëlqesinë e Saj, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, për fjalën e saj të rastit për Ditën e Pavarësisë.

Urdhëroni, zonja Presidente!

PRESIDENTJA E KOSOVËS VJOSA SADIRU-OSMANI: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit, z. Konjufca,

I nderuar kryeministër, z. Kurti,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar përfaqësues diplomatikë të shteteve mike,

Të nderuar ish-presidentë e ish-kryeministra,
E nderuara Familje Rugova, Familje Jashari, Familje të Dëshmorëve,
Përfaqësues të institucioneve të sigurisë,
Shumë të dashur qytetarë të Republikës sonë,
Urime përvjetori i 16-të i pavarësisë!

Është nder i madh për mua që në këtë ditëlindje të gjashtëmbëdhjetë të Republikës sonë t'ju drejtohem nga foltorja e tempullit të demokracisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe t'i uroj qytetarët e republikës sonë, të cilët, sot, me krenari e gëzim festojnë rritën e Kosovës sonë të dashur.

17 Shkurti është e arritura jonë më e madhe historike. Është reflektim i idealit tonë, i gjyshërve e i stërgjyshërve tanë, i brezave të tërë ndër shekuj, për të ndërtuar shtetin e lirë e të pavarur, në të cilin liritë e të drejtat njerëzore, paqja e harmonia janë thelbësore për suksesin tonë. Republika jonë e re po konsolidohet çdo ditë, duke i nderuar qytetarët e vet dhe emrin e tyre në botë.

Për qytetarët e Kosovës, të kesh shtet ka qenë gjithmonë sakrificë e ideal. Ky ideal i rrëmbeu zemrat, e shumë herë edhe jetën e brezave të tërë, të etërve tanë, të nënave, të motrave e të vëllezërve, të gjyshërve e të stërgjyshërve tanë, të cilët dhanë fort për këtë tokë dhe e mbajtën të ndezur flakadanin e lirisë deri te brezi ynë.

E, ne do ta shpiem tutje atë, sepse liria nënkupton për ne vetë karakterin e ekzistencës njerëzore.

Të dashur qytetarë,
17 Shkurti, po aq sa është datë unike për peshën e saj historike, është po kaq shumë një datë e veçantë në rrafshin emocional, duke u shquar si dita e cila na përbashkon rreth një kauze: dashurisë për Republikën dhe përkushtimit për ta ngritur lart emrin e saj.

Rrugëtimi ynë, i shënuar nga sfidat dhe triumfet, është dëshmi e qëndrueshmërisë së shpirtit njerëzor dhe është një histori që vazhdon të zhvillohet me çdo ditë që kalon.

Me gjithë vështirësitë shekullore, ne rezistuaam dhe e mbajtëm kokën me shumë krenari e vendosmëri lart, jo vetëm duke u shpërfaqur si shembull i shtetndërtimit të rrënjësor në vlera demokratike, por edhe duke u zotuar që çdo ditë e re do të na gjejë më mirë se dita paraprake.

Kosova sovrane është dëshmi e asaj që mund të arrihet kur vullneti i pamposhtur i qytetarëve bashkohet rreth një qëllimi të përbashkët.

Prandaj, le t'i gëzohemi lumturisë që sjell fakti se ne tashmë jemi popull i lirë, mes popujsh të lirë, qytetarë të lirë, në vendin tonë, në tokën tonë.

Sot, përulemi së pari para brezave që iu dedikuan lirisë. Le t'i kujtojmë sot ata. Le ta bashkojmë fuqinë tonë, shpirtin tonë, në kujtim të etërve themelues, të grave e të burrave, të bijve e bijave të kësaj toke, të cilët sakrifkuan gjithçka; që nuk u dorëzuan, pavarësisht se historia u soll pabesisht me ta.

Është koha të kthehemi pas e të shikojmë rrugëtimin tonë, përpjekjen e palëkundur për liri dhe t'i kujtojmë ata që e mbajtën të gjallë idealin për shtetin dhe luftuan për të, nga vizionari i madh e arkitekti i pavarësisë, Presidenti Ibrahim Rugova; deri te shembulli i rezistencës e i sakrificës njerëzore, Kryekomandanti Legjendar Adem Jashari.

Nga delegatët e 2 Korrikut e deri te përfaqësuesit e popullit, që e shpallën pavarësinë më 17 Shkurt. Kujtojmë, mbi të gjitha, dëshmorët dhe martirët e lirisë, gjaku i të cilëve është bazamenti më i fortë i shtetit tonë. Kjo është Kosova, e cila asnjëherë nuk u përkul, mbajti të gjallë frymën e lirisë dhe të dashurisë për vendin.

Të nderuar deputetë,

Në zemër të rrugëtimin tonë qëndron edhe forca e aleancave tona. Andaj, sot, në mënyrë të veçantë dua t'u falënderohemi miqve tanë - miqve të lirisë.

Ju ishit me ne përgjatë gjithë rrugëtimin tonë; kur neve na mohohej çdo e drejtë, kur shtypshim mizorisht e kur luftonim për liri, kur u çliruam dhe kur e ndërtoam shtetin tonë dhe institucionet tona demokratike, e ju kemi pranë pa asnjë dyshim edhe sot në mbrojtje të sovranitetit të kufijve tanë dhe të demokracisë sonë.

Ndër këto aleanca, aleanca jonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndron si shtylla më e fuqishme e shtetësisë sonë, ndërkaq rrugëtimi ynë drejt institucioneve euroatlantike është i paalternativë. Këto partneritete, bazuar në respektin e ndërsjellë dhe vlerat e përbashkëta, kanë qenë dhe mbeten jetike për zhvillimin e shtetit tonë.

Këto aleanca na kujtojnë se lufta jonë për liri, e shënjuar me gjakun e të gjithë atyre që u sakrifkuan në mënyrën më sublime, dallohet edhe për mbështetjen e pakursyer e të shenjtë nga ata që ndajnë me ne angazhimin e përbashkët për demokraci, sovranitet dhe dinjtë.

Të mos harrojmë asnjëherë se Kosova fitoi, jo vetëm se pse kishte çdo të drejtë, jo vetëm se pse ishte në anën e drejtë të historisë, por Kosova fitoi edhe se pse veçoi mençur e ndërtoi vizon dhe aleanca të bazuara në vlera.

Të dashur qytetarë,

Në jetën e shteteve, 16 vjet nuk janë shumë. Mirëpo, Kosova për këto vite është zhvilluar e forcuar si shtet i ri dhe ka dëshmuar kulturë demokratike në organizimin e jetës politike dhe në funksionimin e institucioneve demokratike.

Angazhimi ynë për paqen dhe bashkëpunimin rajonal mbetet i palëkundur. Në një botë gjithnjë e më të prekur nga përçarjet, konfliktet e polarizimet, duhet të mendojmë si të ngrihemi mbi forcat dashakeqe, e si të punojmë të gjithë së bashku për ta përmirësuar çdo ditë e më shumë jetën e qytetarëve tanë.

Pavarësia jonë nuk është thjesht një simbol i sovranitetit tonë, por edhe një përgjegjësi për të kontribuar vazhdimisht ndaj promovimit të vlerave demokratike, paqes dhe sigurisë në rajon dhe përtej. Uroj që përpjekjet tona për të ndërtuar e kultivuar partneritete të prirën përherë nga bindja se siguria dhe paqja e qëndrueshme nuk vijnë vetëm, por gjithnjë si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta me miq e me aleatë.

Prandaj, ta ruajmë me zell frymën e demokracisë e të bashkëpunimit mbi të cilin është ndërtuar Republika jonë; të angazhohemi me çdo kusht për ta ruajtur sovranitetin të cilin po e forcojmë çdo ditë; e të veprojmë mençur në drejtim të promovimit të vlerave që qëndrojnë në themelet e shtetësisë sonë ditë pas dite.

Të dashur qytetarë,

Gjithë këto arritje u bënë të mundura falë besimit të palëkundur të popullit tonë. Por, ashtu si demokracia, paqja e siguria kërkojnë angazhim të çdoditshëm e të përhershëm.

Në mëngjesin e hershëm të 24 shtatorit të vitit që shkoi, Kosova u sfidua sërish nga hegjemonia e përtejkuqirit verior. Agresioni ndaj shtetit tonë dhe sulmi terrorist e paramilitar, i organizuar dhe i mbështetur nga Serbia, tregoi se reja hegjemone vazhdon ta mbulojë qiellin mbi Serbi - ajo e mban regjimin politik në atë vend të zhytur në errësirën e së kaluarës. Reagimi ynë ndaj agresionit shtetëror serb ishte i vendosur dhe ju siguroj i tillë do të jetë çdoherë. Le të jetë e qartë: prania ushtarake e policore e Serbisë në Kosovë ka përfunduar njëherë e përgjithmonë në qershor të vitit 1999, kur qiellin e Kosovës e pushtoi fryma e lirisë.

Në mëngjesin e 24 shtatorit, djemtë e vajzat tona në uniformë kanë dëshmuar përkushtim e sakrificë për të mbrojtur e mbajtur të lirë vendin e tyre; ata kanë dëshmuar se atdhedashuria është virtyt, e virtyti kërkon edhe sakrificë; me sakrificën e tyre e përkushtimin ndaj atdheut ata dëshmuar se Kosova është dhe do të mbetet e lirë, sovrane dhe e zonja që, së bashku me aleatët e saj, ta mbajë të palëkundur paqen në rajon. Ata i dhanë plotësisht kuptim motos së sivjetme të festimeve: Kosovë, ne të dalim zot! Heroi

Afrim Bunjaku, familjen e të cilit e përshëndetim sot, dha jetën e vetë për t'i dhënë jehonë kumbuese motos: Kosovë, ne të dalim zot; sot e përherë!
I përjetshëm qoftë kujtimi për të dhe për të gjithë heronjtë tanë!

Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Pavarësia nuk është vetëm privilegj, të cilin fati historik e ka ruajtur për ne, por detyrim për t'i ruajtur e kultivuar vlerat dhe traditat tona, për ta ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe për të përfaqësuar dinjitetshëm vlerat tona në skenën ndërkombëtare.

Zemra e shtetit tonë rreh fort nën ritmin e ambicies fisnike e të pashoq të rinisë sonë. Vendi ynë është shembull i një shoqërie civile dinamike dhe i një vendi që konfirmon rolin transformues të përfshirjes së vajzave dhe grave në pozita vendimmarrëse, dhe jo vetëm. Jemi dëshmitarë të asaj se si fuqizimi i grave dhe angazhimi i rinisë, si dhe mbrojtja e avancimi i të drejtave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë janë katalizatorë të ndryshimit pozitiv. Angazhimi ynë ndaj këtyre parimeve duhet të vazhdojë të mbetet i palëkundur, sepse e dimë që një shoqëri që i vlerëson të gjithë anëtarët e saj pa dallim, që u jep zë atyre që nuk kanë zë, është një shoqëri e së tashmes më të mirë dhe e të ardhmes më premtuese.

Duke shikuar përpara, sytë tanë janë të fiksuar fort në horizont, drejt të ardhmes sonë në familjen euroatlantike. Ky vizion për shtetin tonë nuk është thjesht një ëndërr, por është qëllim historik, të cilin do ta arrijmë së bashku.

Në këtë ditë festimi, le të ripërtërijmë angazhimin tonë ndaj vlerave që na përcaktojnë, ndaj aleancave që na forcojnë, dhe ndaj të ardhmes që na pret.

Bekuar qoftë populli yt, Kosovë, Dardani e lashtë!

Urime Dita e Pavarësisë! Faleminderit!

KRYETARI: E falënderojmë Presidenten e vendit. Tash më lejoni që unë të ju drejtohem me një fjalë të rastit.

GLAUK KONJUFGA: E nderuara Presidente Osmani-Sadriu,
Kryeministër Kurti,
Ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve tona shtetërore,
Zonja dhe zotërinj,
Sot po e festojmë ditën e shtetit tonë, Ditën e Pavarësisë.

U deshën vite të panumërta, përpjekje e brezave të shumtë, mund kolosal e sakrificë sublime për të lindur Republika e Kosovës.

17 Shkurti është dita e frymëzimit, prandaj duhet të jetë ditë përkuljesh para atyre që dhanë më së shumti.

Përkulemi para atyre që e dhanë jetën për liri.

Përkulemi para vëllezërve e motrave tona që u vranë nga Serbia, vetëm pse ishin shqiptarë.

Në themelin e shtetit tonë qëndron heroizmi i Jasharëve, urtësia e Ibrahim Rugovës dhe ideali i Adem Demaçit.

I kemi në zemër të gjithë ata që nuk iu trembën burgjeve.

Ata të cilët nëpër demonstrata u dolën përballë tankeve e policëve të Serbisë.

Minatorët e studentët, profesorët, intelektualët e akademikët, aktivistët e veprimtarët politikë, të cilët nuk kursyen asgjë për Republikën e Kosovës.

Por, mbi të gjitha, i përkulemi popullit tonë të pamposhtur, i cili vjen nga thellësitë e lashtësisë, gjithmonë në tokën e vet dhe me dashurinë e tij të paepur për liri.

Në këtë frymë të lirisë u edukuam vetë dhe me këtë frymëzim do t'i rritim fëmijët tanë.

Për të lindur shteti ynë, ne duruam shumë dhe gjatë.

Ne duruam deri kur bota demokratike u bind se kemi të drejtë.

Kur bota e pa se ne si popull më parë e japim jetën për liri sesa nënshtrohemi para Serbisë, kur bota e kuptoi se lufta jonë çlirimtare është e pastër, na ndihmoi për ta larguar okupatorin.

Durimin e kemi për të mos u nënshtruar dhe për të mos gabuar, kurse guximin e kemi për të vepruar kur është koha dhe për t'u çliruar.

Ne si popull e kemi edhe durimin, edhe guximin.

I kemi gjithnjë në mendje dhe nuk harrojmë t'i falënderojmë miqtë tanë, pa të cilët rruga e shtetit tonë do të ishte e pamundshme.

Para së gjithash, SHBA-në.

Pastaj shtetet e BE-së, të cilat e përkrahën hapur lirinë e Kosovës.

E falënderojmë NATO-n që e përdori forcën për ta ndalur gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Por, i falënderojmë edhe të gjitha shtetet, të gjitha vendet të cilat e njohën pavarësinë e Kosovës.

Urime Dita e Pavarësisë! Lavdi të rënëve!

Festofshim gjithmonë bashkë dhe gjithnjë e më të fortë!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti. Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Shkëlqesia e juaj, znj. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës,

I nderuari kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Zëvendëskryeministra e ministra të Qeverisë,

Shkëlqesi ambasadorë dhe miq ndërkombëtarë,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

Të nderuar udhëheqës e përfaqësues të institucioneve shtetërore,

Të nderuar prijës fetarë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Edhe sot, si çdo vit, mblihdemi për të urrear ditëlindjen e pavarësisë së Kosovës. Me 16 vitet e saj mbi supe, Republika e Kosovës është më e reja në rajon, më e reja si shtet e shtat, por me vetëdijen e pjekur, po aq sa edhe vetëdija e shteteve më të vjetra se ajo.

Sepse Republika e Kosovës më 2008 ishte tashmë e maturuar, si realizim i një aspirote popullore të brumosur për shumë vite e dekada. Kosovën e kanë pjekur para kohe kryengritjet për bashkimin e vilajeteve dhe pavarësinë e Shqipërisë; atë e ka pjekur qëndresa e popullit tonë ndaj valëve të njëpasnjëshme të pushtimeve dhe gjenocideve.

Koha e saj kishte ardhur më 1981, kur anembanë shtetit të saj njerëzit mbushnin sheshet e u dilnin përballë tankeve, duke thirrur “Kosova Republikë!”. Kosova u bë republikë me Kushtetutë në Kuvendin e Kaçanikut, për të u luftua me demonstrata e protesta paqësore dhe me pushkë lirie të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me flijimet që bëri për idenë e republikës, populli ynë në Kosovë e fitoi simpatinë e shteteve demokratike e përparimtare, që i dolën në krah në vitin 1999. Më 2008 nuk kishte mbetur më asnjë dilemë të bashkësia e vendeve demokratike që Republika e Kosovës do të vinte, por diskutohej të vinte në një trajtë të tillë që ishte e pranueshme edhe për armikun më të madh të saj, shtetin serb, që kishte dashur ta mbyste edhe idenë e shtetit të shqiptarët.

Të nderuar qytetarë e qytetare të Republikës,
Të gjithë ne e kemi të qartë se në rast se Serbia shtetërore do të ishte ndjerë sadopak përgjegjëse për gjenocidin në Kosovë, nëse në politikën e saj do të kishte mbizotëruar arsyeja dhe jo revansizmi shovinist, ajo do të duhej ta kishte njohur Kosovën qysh në vitin 2008. Republika e Kosovës garanton të drejtat më të gjera për pakicat në rajonin tonë, posaçërisht për serbët, që përfitojnë e kontribuojnë në shtetin tonë të përbashkët.

Ndërkaq, shqiptarët në Luginën e Preshevës janë pakica më e diskriminuar në Evropë, që dhe sot po i nënshtrohet spastrimit nëpërmjet të ashtuquajturit “pasivizim të adresave”. Është për keqardhje e fatkeqe që fqinji ynë verior ka zgjedhur rrugën e konfrontimit dhe të bllokimit të funksionimit të brendshëm të republikës sonë dhe të njohjeve të saj së jashtmi.

Ajo fillimisht kishte refuzuar propozimin franko-gjerman, e sot vazhdon të refuzojë nënshkrimin e Marrëveshjes Bazike për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, që sjell fqinjësi të mirë evropiane.

Në vend të saj, ajo madje e përqafoi terrorizmin.

Edhe aty dështoi me turp, përballë heroizmit dhe profesionalizmit të Policisë sonë. Mirëpo, për mbrojtjen e Republikës sonë prej terroristëve të financuar, ushtruar dhe drejtuar nga Serbia, u desh që përsëri të jepnim dëshmorë. Rreshteri Afrim Bunjaku i shtohet plejadës së dëshmorëve tonë. Pa sakrificën sublime të tyre ne nuk do ta përkujtonim sot përvjetorin e Republikës.

Lavdi dëshmorëve! Republika kurrë nuk ju harron!

Të nderuar deputetë të Kuvendit dhe pjesëmarrës të tjerë në këtë mbledhje të ditës së shënuar të 17 Shkurtit,

Republikës i dalim zot, të gjithë, secili, secila, bashkë! Republika, ashtu siç e ka konceptuar 125 vjet më parë patrioti Sami Frashëri te manifesti i tij politik, është e nevojshme për mbrojtje dhe për zhvillim. Ne nuk e negociojmë ekzistencën tonë, lirinë tonë dhe të drejtën tonë për t'u mbrojtur e zhvilluar, prandaj përditë si Qeveri e Kosovës marrim masa për ta ndërtuar shtetin ligjor, për t'i forcuar demokracinë dhe llogaridhënien, për të përfshirë dhe ndihmuar të gjithë qytetarët, pavarësisht prej etnisë apo gjinisë së tyre.

Kosova së fundi ka bërë përparime të rëndësishme, në mbrojtje e siguri, në respektimin e ligjit dhe në forcimin e një shteti social që adreson nevojat e qytetarëve, në mënyrë që atyre t'u jepet mundësi për të jetuar me dinjitet. Që nga 1 janari i këtij viti, qytetarët tanë lëvizin pa viza në Zonën Shengen, duke bërë që të intensifikohen marrëdhëniet me Diasporën tonë të madhe që ka kontribuar kaq shumë për shtetin tonë.

Kosova renditet ndër demokracitë e suksesshme në rajon, ndërkohë që vende të tjera kanë bërë hapa mbrapa, duke kufizuar liritë e qytetarëve dhe duke kërcënuar edhe vende të tjera të rajonit. Kosova mbetet e përkushtuar për Procesin e Berlinit, për Planin e Rritjes, dhe do të vijojë punët me partnerët e aleatët tanë perëndimorë për qëllimin e anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Sidomos anëtarësimi i Kosovës në NATO është një imperativ për të garantuar sovranitetin e shtetit tonë dhe për të penguar influencat e Rusisë në rajonin tonë.

Bashkëpunimi me Shqipërinë do të shtohet dhe Qeveria e Kosovës mbetet e zotuar për t'i zbatuar marrëveshjet midis dy shteteve tona. Kosova është në krah të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi, si shtete fqinje me të cilat ne ndajmë vlera të njëjta. Ne besojmë se qytetarët shqiptarë në këto vende do të jenë një faktor për paqe, drejtësi, demokraci dhe aleancë me Perëndimin.

Sipas parashikimeve të Bankës Botërore, Republika jonë më 2024 pritet të ketë rritjen më të lartë ekonomike në rajon. Do t'u japim shtysë projekteve zhvillimore dhe mbështetjes sociale për jetesën e mirë në Republikë demokratike.

Në ditëlindjen e 16-të të pavarësisë, falënderojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Italinë, Turqinë dhe vendet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian e të NATO-s. Falënderojmë të gjitha 117 shtetet njohëse të pavarësisë anembanë globit: nga Kanadaja te Australia e Zelanda e Re, nga Japonia te Panamaja e Peruja. Në veçanti falënderojmë Shqipërinë, mbarë popullin e saj, strukturat shtetërore e partiake dhe udhëheqjet politike e shoqërore.

Falënderojmë partitë politike të Kosovës, këtu në Parlament e ato jashtë parlamentare, pakicat kombëtare - pra serbët, boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, romët, egjiptianët e goranët - dhe organizatat joqeveritare - pra shoqërinë civile e mediat - klerikët fetarë dhe të gjithë profesionistët e vendit tonë për kontributin në Republikën tonë.

Me 16 vitet e saj, Republika gëzon shëndet e bukuri dhe ne do të bëjmë çmos që ajo të begatohet dhe të zbukurohet edhe në të ardhmen, sepse të gjithë ne, si popull e si institucione, jemi të vendosur për t'i dalë zot Kosovës sonë.

Urime! Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash i ftojme edhe grupet parlamentare, partitë politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvend. Fillimisht ia japim fjalën grupit parlamentar të mazhorancës, Grupit të Vetëvendosjes. Kryetarja, Kusari-Lila!

MIMOZA KUSARI-LILA: E nderuara Presidente e Republikës, Vjosa Osmani - Sadriu,
I nderuar kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca,
I nderuar Kryeministër, Albin Kurti, me Kabinetin qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar ambasadorë të vendeve mike dhe partnere të Republikës së Kosovës,
Ambasador Hovenier, Malajt, Szunyog, Shkëlqesi, mysafirë dhe përfaqësues nga vendet mike,
Mirë se erdhët në Kosovë përfaqësues të Mbretërisë së Bashkuar, deputetët znj. Fiona Bruce dhe z. Martin Vickers,
President Sejdiu,
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese Cakaj - Nimani,
Komandat i Ushtrisë së Kosovës, Gjeneral Bashkim Jashari,
Familje të respektuara të dëshmorëve,
Të nderuar veteranë dhe invalidë të UÇK-së,
Të respektuar prijës fetarë,
Qytetarë të nderuar të Republikës sonë,
Gëzuar përvjetori i Pavarësisë së shtetit të cilin po e nderojmë gëzojmë dhe ndërtojmë çdo ditë!

Ka disa javë që oborri dhe hapësirat e Kuvendit të Republikës gumëzhijnë nga zërat dhe prania e qindra fëmijëve nga mbarë Kosova, të cilët të organizuar erdhën në vigjilje të festës së pavarësisë. Ata e vizitojnë institucionin prej nga buroi vullneti i qytetarëve të këtij vendi për ta shpallë 16 vjet më parë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Të gjithë ata fëmijë me rroba festive, shumica me ngjyrat e flamurit shtetëror kaltër dhe verdhë, të tjerët me ngjyrat e flamurit kombëtar kuqezi, bashkë me uniformën emblematike të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës. Fëmijët përçojnë gëzimin, shpresën dhe porosinë për përgjegjësinë tonë që shtetin ta forcojmë dhe demokracinë të zbatojmë çdo ditë.

Megjithatë, jo shumë larg në historinë tonë, edhe fëmijët e Kosovës u sakrifikuan dhe bashkë me heronjtë u bënë pjesë e flijimit dhe pavdekshmërisë për lirinë e vendit. Sado të vegjël në moshë, ata nuk u kursyen nga terrori dhe vrasja. Për lirinë dhe shtetin tonë u sakrifikuan 1 133 fëmijë, prej të cilëve 109 ende janë të pagjetur.

Liria dhe shteti ynë janë të çmuar dhe ashtu sikur vlera e tyre duhet të jetë përpjekja jonë që historia dhe e kaluara kurrë më nuk do të përsëriten në këtë nënqiell.

Nga ajo çfarë po ndodh në kontinentin tonë, e kemi të qartë së liria dhe demokracia nuk duhet marrë për të mirëqena. Liria dhe demokracia po rrezikohen. Shtetet autokrate sikur Rusia me diktaturë të instaluar sulmojnë shtetet fqinje të pavarura, vrasin oponentët politikë të burgosur, ndërsa proksi i tyre tërbohët nga nderimi në varrin e 7-vjeçares së vrarë në Kosovë, Blerina Jashari, dhe nga mllefi i krimit për të cilin asnjëherë nuk kërkuan falje, persekutojnë edhe ata që kanë guxim të kërkojnë falje për vrasjen e saj.

Shteti dhe demokracia e Kosovës u mbrojtën edhe pas shpalljes së pavarësisë. Heronjtë Enver Zyberi dhe Afrim Bunjaku ranë për të mbetur të pavdekshëm në mbrojtjen e integritetit territorial të shtetit tonë.

Lufta jonë e drejtë për liri dhe shtet po mbrohet edhe sot në Hagë.

Prandaj, është aq me rëndësi që liria dhe demokracia jonë duhen mirëmbajtur dhe duhen krijuar mekanizma për t'u mbrojtur me çdo kusht. Atë ua kemi borxh edhe atyre fëmijëve, të cilët nuk arritëm t'i kursenim nga terrori i luftës.

Fëmijët sot po e mësojnë historinë e lavdishme të brezave para tyre: mençurinë, durimin dhe vizionin e Presidentit Ibrahim Rugova, trimërinë, lavdinë dhe sakrificën e Komandantit Legjendar Adem Jashari me familjen Jashari dhe sakrificën e të gjithë luftëtarëve të lirisë.

Ata do ta kuptojnë dashurinë, mallin dhe flijimin e Nanës Pashkë Marku për djemtë e saj, insistimin e Nanës Ferdonije Çerkezi për ta mbajtur gjallë ndër breza tregimin e sakrificës, insistimin për drejtësi të Shyhrete Berishës, dhimbjen e Zarife Morinës dhe shumë Nënave e Baballarëve tjerë që nuk rreshtin duke kërkuar drejtësi dhe paqe për

fëmijët dhe për familjarët e tyre në amshim. Ata jetojnë për ta treguar pjesën më të vështirë të historisë sonë.

Vasfije Krasniqi kishte vetëm 16 vjet, kur jeta e saj mori plagën më të rëndë, me të cilën do jetojë deri në fund, por pa iu dorëzuar asaj.

Sikur Vasfija, janë edhe mijëra gra e burra të tjerë. Drejtësia për të gjithë ato dhe ata do të rëndojë në ndërgjegjen kolektive derisa të triumfojë.

Andaj, në ditë si kjo duhet kujtuar dhe nderuar mundin, përpjekjen dhe sakrificën e secilit fëmijë, grua dhe burrë, që bënë për të ardhur në ditën e shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Në festa si kjo, fëmijët i gëzohen parakalimit të Ushtrisë së Kosovës. Ata i shikojnë me admirim uniformat e ushtarëve tanë dhe të policëve. Ata nuk frikohen nga ato uniformat. Dhe, ky është sukcesi i Kosovës 16 vjet shtet, kjo është e sotmja dhe e ardhmja e saj.

Të duash vendin, ta respektosh dhe të mos i frikësohesh uniformës së policit dhe ushtarit, por të rritesh krenar dhe të ëndërrosh që një ditë të bëhesh si ata.

Fëmijët sot frymëzohen nga talenti, puna dhe sukcesi i xhudistëve Majlinda Kelmendit, Nora dhe Akil Gjakovës, Distria Krasniqit, bokseres Donjeta Sadiku. Ata e dinë se majat e botës janë të arritshme kur ke përkushtimin dhe guximin e Uta Ibrahimit dhe Mrika Nikçit.

Ata frymëzohen për t'i mbrojtur ngjyrat e flamurit shtetëror duke ndjekur shembullin e tyre, bashkë me shpresën për të parë në një të ardhme në Evropian dhe Botëror me kapitenin Amir Rrahmanin dhe golashënuesin Vedat Muriqi.

Sot vajzat e reja, çikat e Kosovës, janë inspirimi për gjitha vajzat dhe djemtë në mbarë botën.

Fëmijët sot shprehin talentin në art, në kulturë dhe në shkencë, rrëzojnë barrierat dhe kufijtë që shumë gjatë qëndruan të ngrehur për Kosovën. Por, interneti nuk kishte kufij, andaj edhe kur kishim regjimin e vizave mbi 1 000 kompani të reja në sektorin e teknologjisë në shtetin me mbulueshmërinë më plotë të internetit, arritën të krijojnë mrekulli me shërbimet në teknologjinë informative. Këta janë të rinjtë e Kosovës, pengesën e kthyen në mundësi dhe mundësinë në fitore.

Falë tyre jam e bindur se rruga e Kosovës drejt progresit dhe integritimit është e pandalshme. Nuk ka forcë që mund ta ndalë vullnetin e shtetit më të ri për të dëshmuar potencialin dhe pasurinë njerëzore që ka.

Sot kemi festë, jo vetëm në Kosovë, por kudo ku ka shqiptarë dhe komunitete nga Kosova. Dhe, sado larg të jenë ata, sytë i kanë nga vendlindja e tyre, me zemër e mendje në rrugët dhe sheshet ku festohet përvjetori i pavarësisë.

Për të gjithë ata që sot festojnë jashtë vendit, kam një porosi:

Ejani më shpesh në Kosovë, vizitohuni bukuritë e vendlindjes! Mësojini fëmijët t'iu gëzohen agimit të diellit në Gjeravicë, në Pashtrik, në Luboten e në Sharr, në Shalë e në Bajgorë. Ndiejeni freskinë e Grykës së Rugovës, Drinit, Lumëbardhit dhe Ujmanit.

Pasuritë natyrore duhet t'iu mbrojmë, t'iu ruajmë dhe t'iu kultivojmë për brezat e ardhshëm.

Vizitohuni qendrat inovative dhe hapësirat kreative. Ka mjaftueshëm në Kosovë. Mendoni për ide biznesi dhe bashkëpunimi me të rinjtë nga Kosova.

Kontaktet dhe lidhjet tuaja me botën, sillini në Kosovë. Jemi gati për fazën e re të zhvillimit të shpejtë.

Kosova në rrugëtimin e saj drejt shtetit nuk ishte vetëm. Populli lirisht i Kosovës ka miqtë dhe aleatët, të cilët i japin kuptim lirisë dhe shtetit të ri.

Në 16 vjet rrugëtim, ishim bashkë dhe çdo ditë të re do të ecim bashkë me botën demokratike. Ashtu sikur te ne, festa e pavarësisë sonë u shënua në SHBA, në New York, Massachusetts, Iowa, Pennsylvania e Texas. Sot po festohet në Kanada, në Gjermani, në Austri, në Francë dhe në Itali, deri në Australinë e largët. Kjo është lidhja jonë e pathyeshme me miqtë dhe mbështetësit tonë.

Ne ndajmë dhe kultivojmë vlerat e njëjta demokratike dhe aspirojmë cakun e përbashkët të integritimit.

Andaj, për të gjithë, Urime ditëlindja e Kosovës! E gëzofshim e shënofshim me shekuj e gjenerata që do vijnë pas nesh!

Qofsh e bekuar përgjithmonë, Kosova jonë!

KRYETARI: Në emër të Partisë Demokratike, kryetari i këtij Grupi, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të dashur qytetarë,
Të nderuar invalidë, veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Familjeve të dëshmorëve,
E nderuara Presidente Osmani-Sadriu,
I nderuar kryeministër Kurti,
Shumë e nderuar Familje Jashari,
E nderuar Familje Rugova,
Shumë i nderuar komandant i ushtrisë së Kosovës, Gjeneral Bashkim Jashari,
Të nderuar përfaqësues të vendeve mike,
Ambasador Hovenier e Szunyog,
Të nderuar përfaqësues të Diasporës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zoti Berisha,
Të nderuar të pranishëm,

Jemi mbledhur sot ta shënojmë një ditë të veçantë, më të veçantën në historinë e Kosovës, ditën kur u realizua ëndrra e kamotshme e popullit tonë për të qenë zot në vendin tonë, për të pasur shtetin tonë të pavarur e sovran Republikën tonë të mëvetësishme. 16 vjet më parë, në 17 Shkurtin e papërsëritshëm të vitit 2008, Presidenti Hashim Thaçi, asokohe kryeministër i Kosovës, në emër të popullit të Kosovës, i prezantoi Kuvendit të Kosovës Deklaratën e Pavarësisë, nëpërmjet së cilës e shpallën Kosovën shtet të pavarur, sovran e demokratik.

Në fjalën e tij, Presidenti Thaçi e përshkroi 17 Shkurtin ashtu siç ishte në të vërtetë, si sublimim i përpjekjeve shekullore të popullit të Kosovës për liri, si sublimim i përpjekjeve të shumë patriotëve që asnjëherë nuk pushuan së angazhuari për Kosovën, si sublimim i gjakut të shumë brezave të kësaj toke.

Ai që i lexonte këto fjalë, ai që e sublimoi këtë arritje historike e të papërsëritshme për popullin e Kosovës, Presidenti Hashim Thaçi sot nuk e gëzon lirinë e Kosovës, por vepra e tij jeton. Prandaj, sot jemi mbledhur ta shënojmë 16-vjetorin e kësaj vepre historike. Hashim Thaçi dhe shokët e tij, bashkëluftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi e shumë të tjerë, janë në betejën e radhës për Kosovën, duke luftuar për drejtësi dhe për ta pastruar emrin lavdimadh të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilin nuk e ndotën asnjëherë propagandat që vijnë, si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda Kosovës. Kjo festë nuk ka kuptim nëse çdo 17 Shkurt nuk nderojmë burrat dhe gratë që bënë sakrificë të madhe për të ndërtuar një të ardhme të mirë për Kosovën. Nuk ka kuptim nëse çdo 17 Shkurt nuk i kujtojmë me nderim që gjithë ata burra e gra që ndër dekada kontribuan që 17 Shkurti të bëhet realitet, që Kosova të bëhet shtet i pavarur, sovran.

Prandaj, çdo 17 Shkurt na bën të reflektojmë për të gjithë ata burra dhe gra që sakrifkuan për jetën e tyre, për të gjithë ne. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për kryengritësit shqiptarë që e nisën rezistencën fill pas okupimit të Serbisë së Kralit. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për trimat që ia kthyen pushkën Jugosllavisë e Titos fill pas fitores së partizanëve jugosllavë. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për rininë idealiste, që u rreshtua në organizatat patriotike që vepronin në ilegalitet kundër Jugosllavisë. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për pjesëmarrësit e demonstratave dhe për të burgosurit politikë që pa dyshim ishin celulat e organizimit tonë për liri. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për gratë dhe burrat që u angazhuan në lëvizje paqësore në ngritjen e institucioneve të arsimit e të shëndetësisë, në kushtet e okupimit gjatë gjithë viteve të '90-ta. Çdo 17 Shkurt reflektojmë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e Komandantin Legjendar Adem Jashari. Reflektojmë për të gjithë ato vajza e djem që morën pushkën dhe luftuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Shumë nga ta nuk u kthyen të gjallë në familjet e tyre, nuk e panë Kosovën të lirë, sepse e dhanë jetën për liri.

Prandaj, sot dhe gjithherë, ne e kemi obligim moral që për hir të tyre dhe gjithë atyre brezave që u angazhuan për Kosovën e lirë ta ndërtojmë një Kosovë të zhvilluar e të prosperuar. Ne duhet të angazhohemi që Kosova të jetë një vend që u ofron qytetarëve të saj dhe brezave të rinj shpresë për të jetuar këtu. Shteti i Kosovës ka ende shumë punë për të bërë, por asnjëherë nuk mund ta harrojmë punën e madhe që është bërë deri më sot.

Kosova ishte një vend i rrënuar nga lufta. Kosova nuk kishte polici, ushtri, institucione. Arsimi e shëndetësia ishin jofunksionale. Prapëseprapë, me shumë angazhim të të gjitha qeverive të pasluftës, Kosova bëri hapat të mëdhenj. Përparimin që ka pasur Kosova në 25 vjetët e pasluftës dhe sidomos 16 vjet pas pavarësisë shumëkush e ka mohuar. Serbia nuk ka lënë rast pa e kontestuar çdo arritje të shtetit të Kosovës. Fatkeqësisht, shumë herë këto arritje janë kontestuar edhe nga brenda Republikës së Kosovës.

Përparimi i Kosovës së paspavarësisë është realitet dhe ai përparim edhe mund të preket, edhe mund të shihet në statistika. Natyrisht, ky zhvillim nuk do të mund të ndodhte pa ndihmën e aleatëve tanë perëndimorë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian e me Mbretërinë e Bashkuar, të cilët ndihmuan jashtëzakonisht në këtë rrugëtim. S'mund të ketë festë për 17 Shkurtin pa i falënderuar miqtë tanë, dhe në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian e Mbretërinë e Bashkuar, pa përkrahjen e të cilëve e themi pa dyshim që nuk do të kishte 17 Shkurt.

Prandaj, ne mbetemi këmbëngulës në ndjekjen e një aleance me miqtë tanë ndërkombëtarë dhe pavarësisht zërave që vijnë nga ndonjë lider politik, populli i Kosovës asnjëherë nuk do ta kontestojë miqësinë dhe partneritetin me miqtë tanë ndërkombëtarë,

në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian e me Mbretërinë e Bashkuar.

Ne kemi besuar gjithmonë që Kosova e pavarur do të rrugëtojë drejt së ardhmes euroatlantike vetëm me miq e me dashamirë. Njësoj e kemi pasur të qartë se kur miqtë tanë na thoshin se do të shpallej pavarësia, kur Presidenti amerikan i kohës Xhorxh Bush, nga Tirana tha se u bë mjaft, ne besuam që vërtet u bë mjaft dhe ishte koha për pavarësinë e Kosovës. Shumëkush, jo vetëm nga armiqtë tanë, por edhe nga brenda Kosovës, fatkeqësisht nuk besuan që po shpallet pavarësia. Më pas menduan që edhe nëse shpallet pavarësia, atë nuk do ta njohin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, si miqtë të njëmendtë të Kosovës, SHBA-të nuk na zhgënjyen asnjëherë, i zhgënjyen vetëm skeptikët e orientimit euroatlantik të Kosovës.

Prandaj, në këtë 17 Shkurt e themi prerë se populli i Kosovës nuk meriton një qeverisje që e fut Kosovën në sanksione nga miqtë tanë perëndimorë. 17 Shkurti nuk do të ndodhte pa një kombinim perfekt të përkrahjes ndërkombëtare dhe angazhimit të shumë brezave e lëvizjeve politike, që ndër dekada u angazhuan për Kosovën e lirë. Prandaj, edhe këtë 17 Shkurt, po kujtojmë aleatët tanë, sikur kujtojmë paraardhësit tanë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Presidenti Hashim Thaçi thoshte se po e lexonte Deklaratën e Pavarësisë duke ndier rrahjet e zemrave të stërgjyshërve tanë. Ne sot duhet të ndiejmë rrahjet e zemrave të stërnipërve tanë që do të rriten në Kosovë. Duhet të mendojmë për ta. Duhet ta kemi mision jetësor që brezat e ardhshëm të jetojnë në Kosovë të prosperuar e të zhvilluar. Duhet të mendojmë për Kosovën e së ardhmes, me ekonomi, me arsim e me shëndetësi të zhvilluar. Për Kosovën pa sanksione, por në aleancë të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian e me Mbretërinë e Bashkuar. Për Kosovën, nga ku qytetarët e saj nuk duan të ikin nga ajo, por duan ta ndërtojnë jetën e tyre të lumtur këtu.

Qytetarët e Kosovës meritojnë një jetë më të mirë. Qytetarët e Kosovës kanë sakrifikuar shumë dhe meritojnë të ardhme të zhvilluar. Të gjithë qytetarëve të Kosovës urime 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Kosovës! Urime!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i kësaj partie, Lumir Abdixhiku. Urdhëroni, zoti Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: E nderuara Presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu,

I nderuar President Sejdiu,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryeministër i Kosovës,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Ushtarakë e oficerë të Forcës së Kosovës,
Familjarë të dëshmorëve, veteranë të luftës çlirimtare,
Përfaqësues të institucioneve vendore,
Qytetarë të nderuar të Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Në 16-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, kësaj ngjarjeje madhore të historisë tonë, në frymën e festës dhe të gëzimit, më lejoni që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës të ju uroj të gjithëve për këtë ditë të shënuar. Le të shërbejë kjo ditë e kjo datë si frymëzim e një nxitjeje pozitive, që të punojmë më shumë e më me vullnet më të mirë për vendin tonë, atdheun tonë, Republikën tonë, që të zotërojë paqja, liria dhe demokracia, vlera e ideale për të cilat u angazhuam me dekada të palëkundur, përkundër shtypjes, terrorit, të dhunës e luftës.

Është detyrë jona që këto vlera t'i ruajmë, por edhe t'ua përcjellim brez nive që vijnë, sepse kështu e bëjmë vendin tonë një çerdhe të ëndrrave e vlerave tona të përbashkëta. Në këtë ditë e datë të shënuar historike, ne kujtojmë dhe nderojmë gjithë rrugëtimin tonë kombëtar, kontributin e brezave të tërë që në kohë e periudha të vështira historike mbajtën fort, mbajtën drejt, mbajtën barrë gjithë ëndrrën tonë shekullore për liri, për shtetësi e për barabarësi ndërmjet kombeve evropiane. Sot tekса qëndrojmë në tempullin e shenjtë të shpalljes së pavarësisë, të trimëruar nga shpirti i të parëve tanë dhe vullneti i paepur i popullit tonë, ne me mburrje e nderojmë trimërinë dhe sakrificat e bëra për të krijuar një shtet sovran, të lirë dhe të mbushur me premtimin e demokracisë.

Prandaj, sot në këtë ditë madhështore ne kujtojmë me nderim e mirënjohje lëvizjen më të madhe shqiptare në Kosovë, atë për liri, për pavarësi e për demokraci. Kujtojmë momentin e bashkimit tonë si popull rreth idealeve të palëkundura e të pathyeshme atyre që na shtynë të ëndërrojmë e të përpiqemi për të drejtën tonë historike të lirisë dhe pavarësisë.

Sot falënderojmë të gjithë aktivistët e vullnetarët që mirëmbajtën jetën tonë institucionale gjatë viteve të '90-ta dhe i dhanë shpirt e nxitje lëvizjes sonë. Në mënyrë të veçantë, në këtë ditë të shënuar të historisë e nderojmë me vlerësimin më të epërm prijësin e rrugës sonë, kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Presidentin historik të vendit tonë, Doktor Ibrahim Rugova, vizioni i të cilit i artikuluar me mençuri të pashoq në fillim të viteve të '90-ta, u bë realitet në vitin '99, kur bota u bashkua me ne dhe në vitin 2008, kur përsëri ishte me ne ditën që shpallëm pavarësinë e vendit tonë, për të qëndruar përkrah nesh përgjatë rrugëtimin tonë të derisotshëm.

Po ashtu, në këtë ditë të bukur shpreh mirënjohjen tonë të thellë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, atyre burra e grave që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë, vlerësimi e mirënjohja për të cilën nuk do të shuhet kurrë. Në këtë ditë kujtojmë me mirënjohje e nderim sakrificën e Jasharajve, flijimi i të cilëve ishte kushtim për çlirimin tonë përfundimtar.

Të nderojmë të gjithë ata që u flijuan në altarin e pavarësisë së Kosovës, dëshmorët, viktimat e pafajshëm të luftës, emrat e të cilëve janë të gdhendur me shkronja të bukura e të pashlyeshme në historinë e vendit tonë.

Republika e Kosovës u bë shtet i pavarur dhe sovran falë unitetit tonë të brendshëm, lëvizjes paqësore e luftës çlirimtare, si dhe mbështetjes ushtarake dhe diplomatike nga jashtë. U bë, sepse treguam e dëshmuam kulturë të brendshme politike, dhamë gjithë potencialin tonë kombëtar e krijuam ura bashkëpunimi mes vete dhe me aleatët.

Prandaj, kapërcyem sfida të pakapërcyeshme më parë. Në këtë ditë të 17 Shkurtit dhe jo vetëm ndiejmë detyrimin tonë për mirënjohje e falënderim ndaj aleatëve tanë nga e gjithë bota. Në veçanti, mirënjohje të veçantë të gjitha shteteve të Aleancës Veriatlantike, të kryesuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e nga Bashkimi Evropian, që në orët më të vështira u gjendën pranë nesh.

Shtëpia nuk mbahet pa miq, nuk mbahej dje, s'mbahet sot, s'do të mbahet as nesër. Në fjalë e Presidentit Regan: Liria kurrë nuk është më larg se një brez larg zhdukjes, atë s'e trashëgojmë nëpërmjet lidhjes së gjakut tek brezat e tjerë. Ajo duhet të mësohet, duhet të luftohet për të, të mbrohet dhe të dorëzohet te të tjerët që të bëjnë të njëjtën gjë sikur bëmë ne. Sikur liria, edhe aleancat tona nuk trashëgohen, ato fitohen, ruhen, mësohen e dorëzohen te brezat e tjerë.

Si gjeneratë politike e sotme e kemi për obligim, jo si borxh detyrimi, por si sjellje fisnike e si besim që këto aleanca t'ua mësojmë breznive që vijnë, sepse kështu na mësoan prijësit tanë si mësonjës të mirë që ishin. Sepse kështu duhet ta përcjellim tutje si liderë të përgjegjshëm e me besim euroatlantik që duhet të keni.

Aleatëve tanë që edhe sot na qëndrojnë në këtë shtëpi të madhe të demokracisë dhe shpalljes së pavarësisë ua shtrijmë dorën e miqësisë dhe bashkëpunimit. Le të punojmë së bashku për një Kosovë që ne e ëndërrojmë bashkërisht.

Sot, në ditëlindjen e 16-të, Kosova është e bekuar që është pjesë e vendeve të lira e demokratike, ku liria është vlerë sublime njerëzore, e politika veprimtari e njerëzve të lirë. Kosova në këto dekada të lirisë e pavarësisë e ka shënuar progresin më të madh në

historinë e saj disashekullore, progres të cilin e kemi detyrë ta ruajmë dhe ta çojmë një hap tutje. Rezultatet që kemi arritur duhet të shërbejnë si udhëndriçues që të këndellemi e të ecim të bashkuar drejt së ardhmes më të ndritshme, duke mos kërkuar barriera në çdo mundësi, por duke punuar në frymën e tolerancës, të mirëbesimit e të vullnetit të mirë.

E shkuara jonë është e lavdishme dhe e papërsëritshme. Mbi të gjitha, është e paarritshme dhe e pandryshueshme. E ardhmja jonë është e padefinuar, është e pashkruar dhe aty sot kemi rol ne. Aty e përcaktojmë kujtimin e njerëzve të tjerë. Në këtë të ardhme, ne i përcaktojmë edhe kujtimet tona si shoqëri në rrugëtimin origjinal për në NATO dhe për në Bashkimin Evropian. Këtë rrugë ta bëjmë ne, si testament për gjeneratat që vijnë, si mirënjohje për ato që s'janë më.

Rrugëtimi ynë si shtet krenar, me njerëz të jashtëzakonshëm e të ardhme të ndritshme do të vazhdojë, sepse ky rrugëtim s'ka kthim prapa, sepse Kosova, atdheu ynë është i përhershëm, sepse Republika është e përhershme dhe e pavdekshme.

Zoti e bekoftë Kosovën tonë të bukur, njerëzit e saj punëtorë e të devotshëm, miqtë tanë dhe aleatët e palëkundur!

Zoti e bekoftë këtë ditë! Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i këtij grupi, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit kryetar i Kuvendit, z. Glauk Konjufca!

E nderuar Presidente,

I nderuar Kryeministër,

Familjarë të dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Shumë i respektuar komandant i FSK-së, Bashkim Jashari,

Ish-president Sejdiu,

Më lejoni që po ashtu të përshëndes sot edhe presidentin e Shoqatës Panshqiptare në Amerikë, z. Elmi Berisha, që është edhe presidenti i parë i kësaj organizate nga Kosova.

Të respektuar përfaqësues të Korit diplomatik,

Ambasador Jeffrey Hovenier,

Ambasador Nik Abot, i cili shërbeu për katër vite dhe shumë shpejt do të largohet nga këtu,

Përfaqësues të vendeve anëtare të BE-së,

Ambasador i BE-së,

Shumë të respektuar qytetarë të Kosovës,

Kolegë deputetë,

Në këtë datë historike pa dyshim në këtë datë feste dhe kremte në shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë së vendit tonë, nderojmë e lartësojmë veprat dhe gjithë përpjekjet shekullore të popullit tonë për liri.

Pavarësia e këtij vendi është akti që na bashkoi të gjithëve, pra të gjithë ishim një në këtë rrugëtim. Ata që sot s'janë me ne, që ranë dhe dhanë gjithçka, dhanë edhe jetën e tyre për këtë ëndërr, ne që e kemi fatin ta jetojmë dhe pa dyshim brezat e gjeneratat që do të vijnë pas nesh.

Nuk mund në këtë ditë pa e evokuar e reflektuar një rrugëtim të vështirë të këtij kombi e të këtij vendi. Vetëm tri dekada më parë, në vitet '90-ta, një popull i tërë ishte gjetur në aparteid shtetëror, diferencim, përjashtim nga puna, nga jeta politike e institucionale e kulturore, mbyllja e universiteteve e shkollave, mediave e zërit të lirë. Gjithçka dukej sikur kishte marrë ngjyra të zbehta, toka dhe qielli dukeshin ndryshe. Për të kulmuar në vitet 1998-1999 me një luftë që la pasoja të mëdha dhe që pati një çmim të madh për këtë vend e për këtë popull. Mbi një milion qytetarë u deportuan me dhunë nga Kosova, gjysma tjetër të ngujuar në Kosovë, qindra e mijëra të vrarë e të masakruar, mijëra gra të dhunuara, e pasuria jonë tërësisht e shkatërruar.

Mbi këto, njerëzit e këtij vendi, burra e gra u ngritën në solidaritet për mbijetesë. E mbajtën gjallë arsimin, edukimin, duke i bërë shtëpitë e tyre shkolla, duke ndarë shumë pak çka patën për të financuar sistemin paralel, sistemin arsimor. Me misionin e me emrin e Nënës Terezë u dhanë e u ushqyen me mijëra familje, të cilat ishin në varfëri të skajshme, e u dhanë shumë shërbime shëndetësore.

Zërat e guximshëm atëbotë të gazetarëve e të politikanëve dokumentuan e ndanë me botën demokratike informacione për ngjarjet dhe tragjeditë e familjeve të shumta, përderisa në salla e fusha të improvizuara atëbotë zhvilloheshin ngjarjet kulturore, arsimore e sportive.

Nuk mund ta harrojmë rolin e mërgatës. Ajo u bë dora e mbijetesës, u bë fjala e Kosovës në Evropë e Amerikë, e krahu i fortë i përpjekjeve të luftës për liri. Nën shembullin e rezistencës e guximit të Adem Demaçit, e politikës paqësore e vizionit për ndërkombëtarizimin të Presidentit Ibrahim Rugova, demonstratat, lëvizjet e përpjekjet e të burgosurve politikë, intelektualëve e studentëve, e një popull të tërë, arritëm të bëhemi bashkë, të unifikohe mi e të mobilizohemi si popull i tërë në luftën për liri.

Lufta për liri kulmoi me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me shëmbëlltyrën e flijimit e Komandantit Adem Jashari e Familjes Jashari, që u bë

frymëzim i mijëra luftëtarëve, invalidëve e dëshmorëve, e të cilët ranë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare, e sot prehen në varrezat e dëshmorëve.

Nga përpjekja e një populli, mijëra fëmijë, gra, burra e të moshuar u sakrifkuan për t'u bërë thirrja e forca e botës së civilizuar për shpëtim, me intervenimin e botës demokratike, e NATO-s, e prirë nga Amerika, e shumë vende të tjera që përfaqësojnë vlerat më të larta të humanizmit, të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë.

Të dashur deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mbi këtë sakrificë e mbi këto vlera, së bashku ne e ndërtuam shtetin tonë, Republikën e Kosovës. Një vend në themelet e të cilit sot ekzistojnë dhe janë të betonuara në Kushtetutën e saj të drejtat më të avancuara të njeriut dhe të komuniteteve pakicë, në një shoqëri multietnike e me tolerancë të lartë ndërfetare, parim e vlera këto që duhet t'i ruajmë, që ky është rrugëtimi ynë i cili na garanton suksesin tonë. Një frymëzim që e kemi marrë nga shtetet demokratike, që sot përfaqësuesit e tyre qëndrojnë këtu me ne, vlera që janë euroatlantike, e që në esencë të synimit tonë si shtet e kanë integrimin në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në NATO.

Megjithatë, me sfidat e rrugës përpara pa dyshim ende kemi nevojë ta mbajmë fort unitetin tonë në konsolidimin e plotë të shtetësisë dhe synimeve tona strategjike. Me vendosmëri duhet ta ruajmë partneritetin që e kemi ndërtuar me mund me SHBA-të dhe me vendet e Bashkimit Evropian. Kjo nuk është dëshirë. Ky është obligim që e kemi marrë nga brezat që dhanë gjithçka për këtë liri dhe brezat e fëmijët tanë që do të rriten e nipat e stërnipat tanë që do të jetojnë në këtë vend.

Popull i Kosovës,

Urime të qoftë Pavarësia!

Në këtë ditë nuk mund të ikën prej kësaj foltoreje pa i uruar edhe prijësit tanë të luftës, ish-liderët politikë e institucionalë që sot nuk janë me ne, janë në Hagë, e po na dëgjojnë të mallëngjyer, e t'u them që nuk i kemi harruar, t'u themi që ne besojmë në të drejtën tonë të luftës sonë të pastër, që besojmë në drejtësinë ndërkombëtare dhe jemi të bindur që shpejt do të bashkohemi dhe të festojmë këtu së bashku.

Të dashur deputetë,

Në përmbyllje të kësaj fjale, më lejoni për t'i rikujtuar të gjitha përpjekjet e aleatëve tanë, edhe si kujtim, por edhe si motiv të përbashkët adresimin e Sekretares Medlin Ollbrajt, në dhjetëvjetorin e Pavarësisë. Ajo na u drejtua me një fjalë neve, tha: Kam dëshirë të flaktë t'ju shoh se po përparoni si vend.

Andaj, kjo tokë e bekuar nga Zoti, e larë me gjakun e dëshmorëve, ky shtet i ndërtuar me mund, e që i kanë dalë goxha moti zot djem e vajza në luftë, e i ka dalë zot edhe Enver Zymeri, edhe heroi Afrim Bunjaku, sot ka nevojë më shumë se kurrë për unitet politik, për një vetëdije shtetërore e institucionale, se s'kemi vend tjetër, po e kemi një Kosovë. Një është.

Lavdi atyre që dhanë gjithçka për liri e pavarësi!

Faleminderit Amerikë dhe miq ndërkombëtarë!

Kosovë për hair të qoftë 16-vjetori i Pavarësisë!

Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Multietnik, e ftojme kryetarin e këtij grupi, deputetin Enis Kervan që ta mbajë fjalën e tij.

ENIS KERVAN: Çok teşekkür ederim

Çok değerli Sayın Cumhurbaşkanı Osmani, çok değerli Mecis Başkanım Konyufsa, çok değerli Başbakanım Kurti, değerli Komutan Yaşari, değerli Mevkidaşlarım, Hükümet üyeleri, çok değerli Büyükelçiler, Şehitlerimizin temsilcileri, konuklar, medya mensupları ve çok değerli vatandaşlarımız,

Bugün burada Cumhuriyetimizin Bağımsızlığının 16. Yıldönümü vesilesiyle toplanmış bulunmaktayız.

Çok etnili ve demokratik Kosova'nın en güzel yansıması olan çoğunluk olmayan topluluklar olarak bizler, her süreçte ülkemizin bu günlere ulaşması ve kalkınması için yapıcı roller üstlenerek, gerçek olan bu hikayede üzerimize düşeni yapmışızdır.

Her hikayenin bir konusu ve kahramanları vardır. Son hikayemizin kahramanları ve konusu Kosova Kurtuluş Ordusu savaşçıları ve kurtuluş savaşımız olmuştur. Bu son hikayemizde binlerce Kosovalı şehit olmuş, milyonlarca Kosovalı evlerini, yurtlarını terk etmek zorunda kalmıştır.

Bu hikayede çok acılar yaşadık.

Hikayemizde Halklarımız, topluluklarımız farklı olsa da gözyaşlarımızın rengi aynı olmuştur.

Kosova Kurtuluş Ordusu içerisinde çoğunluk olmayan topluluklar olarak biz Türklerin ve diğer toplulukların da askerlerimizin ve şehitlerimizin var oluşu ortak tarihi ve kaderi paylaştığımızın bir göstergesidir. Ve bu gerçek bizleri ayrıca gurulandırmaktadır...

Kurtuluş savaşıyla birlikte Demokratik dünyada, Kosova, halkının çektiği acılara sessiz kalmadı elbet. Kosova'nın özgürlüğü elbette dost ülkelerin de destekleriyle sağlanmıştır. Ve Kosova bugün yine müttefikleriyle gücüne güç katmaktadır.

17 Şubat 2008'de bu mecliste, ilan ettiğimiz "Bağımsız Kosova Cumhuriyeti" Kosova'da yaşayan tüm toplulukların, çocuklarımıza ve yarınlara bırakılmış en büyük miras ve asla vazgeçilmez bir değerdir.

Bağımsızlık ilanı, hiç şüphesiz kurtuluş mücadelemizin, kendi kaderimizi tayin eden davamızın ve bize gösterilen demokratik dünyanın dayanışmasının sonucuydu.

Bu Mecliste, 17 Şubat 2008 yılında Kosova Türkleri adına Kosova Cumhuriyetinin Bağımsızlık Bildirgesini imzalayan milletvekillerinden biri olmanın gururu ve onuruyla, bu kıymetli toprakları bize vatan yapan başta Adem Yaşari olmak üzere, bu kıymetli vatanımızın bölünmez bütünlüğünü, milletin huzur ve istikrarını sağlayan bu ulvi gaye için toprağa şehit düşen Kosovalı Türk şehidimiz Ertan Mazrek'i ve bütün şehitlerimizi rahmetle anıyorum.

- Savaş kayıplarımızın bulunması ve acılı annelerimizin ateşlerinin sönmelerini bir an önce diliyorum.

Bu günlere ulaşmamıza sonsuz katkı sunan dönemin ilk Cumhurbaşkanı, dönem Başbakanı, Meclis Başkanı, Bakan, ve Milletveilleriyle tüm büyüklerimizi saygı ve minnetle anıyorum. Çünkü cumhuriyet fazilettir. Bu değeri, bağımsız ve egemen devletimizi, bu şerefli kazanımı, hep birlikte gelecek yüzyıllara taşımak miras ve emanettir.

Kuruluşunun 16. yılını kutladığımız Kosova Cumhuriyeti'nin bağımsızlık ve toprak bütünlüğü ile çok etnili, çok kültürlü ve demokratik yapısının, bölgesel barış ve istikrar bakımından elzem olduğuna inanmaktayız.

Bugün ülkemiz için son şehidimiz, kahraman polisimiz Afrim Bunjaku'yu anmak boynumuzun borucudur diye düşünüyorum. Polis Bunjaku'nun barışı ve güvenliği korumaya olan bağlılığı, harika polis memurlarımızın yaptığı fedakarlıkların bir kanıtıdır. Unutmayalım ki bu cesur kadın ve erkekler, anayasal düzenimizi yıkmak isteyenlere karşı bizim savunucularımız olmaya devam etmektedir.

Bu yüzden son yıllarda yapılan çalışmalardan ve kurumlarımızın her geçen gün daha iyiye gitmesinden gurur duymamız gerekmektedir.

Dünyanın en genç ülkelerinden biriyiz. Koşullarımıza ve sorunlarımıza rağmen çok önemli gelişmeler kaydettik. Hükümetimiz çok başarılarla imza atmıştır.

Özgür, egemen ve bağımsız devlet olarak artık Bayrağımız ülkemizin her yerinde, her köşesinde, kuzeyinde güneyinde, doğusunda batısında dalgalanıyor ise, bu gerçekten bir başarı var demektir.

Kosovamız,. geleceğe inançlı ve güçlü adımlarla ilerliyor. Çoğunlukta olmayan topluluklar olarak en büyük beklentimiz birkaç ay sonra Avrupa Konseyine üye olmamızdır. Ardından da NATO ve AB üyeliği Kosova olarak en önemli hedeflerimiz arasında yer almaktadır.

Bağımsız Kosova'da tüm topluluklarla birlikte, eğitimden, kültüre, sağlıktan spora, bilimden siyasete, kadınlarımızdan çocuklarımıza, tüm konularda topluluğumuzun sesini duyurmaya ve bu topraklarda var olarak ülkemize katkımızı sunmaya devam edeceğiz.

Topluluklar olarak, Kosova ve Sırbistan arasında nihayi bir anlaşma umut ederek, bu sürecin bir an önce tamamlanmasını bekliyoruz. Ayrıca her iki ülkenin de karşılıklı tanıma ile kapsamlı bir anlaşmaya vararak, vatandaşları için barış, istikrar ve refahı garanti eden tek yol olan Avrupa entegrasyon sürecine doğru ilerlemesini arzuluyoruz.

Her süreçte Kosova'mızın ve bizlerin yanında olan ve çok etnili Kosova'ya destek sunan Amerika, Arnavutluk, her zaman desteklerini esirgemeyen ve bizleri tanıyan ilk ülkelerden biri olan Türkiye, Almanya, Fransa, İtalya, İngiltere, AB'nin dost ülkeleri ve yanımızda olan diğer ülkelere de sonsuz teşekkürlerimi sunmak isterim.

Sözlerimi geçenlerde vefat eden önemli bilgelere Alev Alatlının bir sözüyle noktalamak istiyorum: "Tarih ezelden ebede dümdüz uzanan doğrusal bir hat değil, devirli bir oluşumdur" demiştir kendileri ve ülkesini meyve veren ağaca benzetmiştir.

Bizler de Kosova'yı her budağından sürgün atan salkım saçak bir meyve ağacına benzetebiliriz. Bir sürgünü çiçeğe dururken, diğeri kurumakta oluyor gibi gözükse de, ötekisinin meyve vermekte olduğunu göreceksiniz. Her bir sürgünün farklı hikayesi, anlamları vardır.

Ancak tek bir sürgüne bağlı kalmak yerine bütüne bakmayı öğrenmemiz gerekmektedir.

Bu sürgünün bir parçası Arnavut kardeilerimiz, diğer parçası biz Türkler, diğer parçaları Boşnaklar, Romlar, Aşkaliler, Mısırlılardır. Bir diğer parçası da Kosova'da yaşamıyor olsalar bile bizleri düşünen diğer dost ülkeler ve gurbetçilerimizdir. Bütün parçaların toplanmasıyla birlikte daha fazla anlam ifade edecektir. İşte bizim bu güzel parçalardan oluşan bütünümüzün adı Kosova Cumhuriyetidir.

Her şey bir ülkeyi, devletini ve halkını sevmekle başlar. Bizlerde bu halkların temsilcileri olarak devletimizi sevdiğimizi, sevmeye devam edeceğimizi ve seven nesiller yetiştirmeye gayret edeceğimizi bu kürsüden tekrar ifade ediyoruz.

Gelecek nesillere, refahın, huzurun barışın olduğu bir Kosova Cumhuriyetini yeni bir hikaye olarak miras bırakmanın hayalini yaşıyoruz.

Bu duygu ve düşüncelerle Cumhuriyetimizin 16. yıldönümünü kutlar, kalbi Kosova için atan her vatandaşıma sevgilerimi sunarım.

Lavdi për të gjithë dëshmorët!
Gëzuar 17 Shkurti!
Ju faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,
Ju falënderoj të gjithëve që morët pjesë në këtë seancë solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këtu po i mbyllim punimet e kësaj seance solemne. Gëzuar 17 Shkurtin!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*